

INFORMACION MBI RAPORTIN E MJAFTUESHMERISE SE KAPITALIT

Banka e monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit të saj, përveç masave të tjera, nëpërmjet përdorimit të rregulloreve dhe raporteve të vendosura nga Rregullatori Shqiptar, Banka e Shqipërisë (“BSH”), e cila përcakton kapitalin rregullator të kërkuar për të mbështetur biznesin. Rregulloret e reja “Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit” dhe “Për kapitalin rregullator” të hyra në fuqi në 2015 mbështeteten në ligjin Nr. 8269, datë 23.12.1997 “Mbi Bankën e Shqipërisë” dhe Ligjin Nr. 9662, datë 18.12.2006 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është raporti i kapitalit rregullator me ekspozimet e ponderuara me rrezikun, llogaritur si totali i vlerave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, si ato në bilanc edhe ato jashtë bilancit, për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, si dhe kërkesat për kapital për rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional.

Minimumi i përqindjes së kapitalit rregullator ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezik që kërkohet nga Banka e Shqipërisë është 12%. Minimumi i treguesit për kapitalin e nivelit të parë është 6% dhe minimumi i treguesit për kapitalin bazë të nivelit të parë është 4.5%.

Në qershor 2020, BKT ka raportuar përqindjet e mëposhtme në nivel të konsoliduar:

- Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit 15.66% (Dhjetor 2019: 18.62%);
- Raporti i kapitalit të nivelit të parë 14.57% (Dhjetor 2019: 17.37%);
- Raporti i kapitalit bazë të nivelit të parë 14.57% (Dhjetor 2019: 17.37%).

Në vijim të transformimit të BKT Kosova në filial gjate vitit 2018, prej dates 1 janar 2019 Banka ka filluar raportimin në baza individuale edhe për qëllime rregullatore. Mbështetur në rregulloren e Bankës së Shqipërisë nr. 4/2017 “Mbi mbikqyrjen e konsoliduar” Banka duhet të monitorojë normën e mjaftueshmërisë së kapitalit në baza individuale. Të njëjtët tregues rregullatorë minimalë zbatohen si më lart.

Në qershor 2020, BKT ka raportuar përqindjet individuale të mëposhtme:

- Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit 17.57% (Dhjetor 2019: 21.75%);
- Raporti i kapitalit të nivelit të parë 16.24% (Dhjetor 2019: 20.19%);
- Raporti i kapitalit bazë të nivelit të parë 16.24% (Dhjetor 2019: 20.19%).